



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE E GJELBËRIMIT

Nr. prot.

Tiranë, më 22.02.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM TË KONTRATËS ME OBJEKT PROKURIMI “BLERJE FSHESA FRYRESE, THITHESE, KARROCA DORE, MATRAPIK, Total station trimble” PËR NEVOJAT E DPPGJ PER VITIN 2023

OBJEKTI I PROCEDURËS: “FSHESA FRYRESE, THITHESE, KARROCA DORE, MATRAPIK, Total station trimble”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT: 42900000-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,000,000 (gjashtemilion) lekë pa TVSH me burim financimi buxhetin afati mesem 3 vjecar 2023-2025.

I mbajtur sot më date **22,02,2023**, në DPPGJ – Tirane, në prani të anëtarëve të Njesisë së Prokurimit të ngritur me Urdhër të Titullarit të AK, për miratimin e dokumentave të tenderit « Tender i hapur i thjeshtuar », bazuar në nenin 55 te VKM 285 dt. 19.05.2021 si dhe nenit 49 te Ligjit 162/2020 «Per Prokurimin Publik» me mjete elektronike, **me afat 10 ditë nga data e lidhjes se kontrates mbi sasitë e mallrave të cilat kërkohet të kontraktohen sipas tabelës si më poshtë vijon:**

SASIA E MALLIT DHE AFATI I LEVRIMIT:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia gjithësej	Afati i Lëvrimit të Mallrave
1	Frezë me dy goma (Diesel)	Copë	2	Ditë 10
2	Motokorëse me (Benzinë)	Copë	8	Ditë 10
3	Motoseke me (Benzinë)	Copë	8	Ditë 10
4	Motosharrë me (Benzinë)	Copë	8	Ditë 10

5	Motosharrë me (Benzinë)	Copë	6	Ditë 10
6	Motosharrë në lartesi me (Benzinë)	Copë	6	Ditë 10
7	Prerëse Bari me (Benzinë)	Copë	8	Ditë 10
8	Traktor korrës me (Benzinë)	Copë	2	Ditë 10
9	Moto Gershërë Krasitje	Copë	8	Ditë 10
10	Pompë Spërktëse Motorike	Copë	8	Ditë 10
11	Fryrëse Gjethesh	Copë	8	Ditë 10
12	Karoca Dorre	Copë	40	Ditë 10
13	Thithëse Gjethesh	Copë	8	Ditë 10
14	Matrapik	Copë	3	Ditë 10
15	Matrapik për Agregate	Copë	1	Ditë 10

Të gjithë artikujt e mësipërm do të dorëzohen pranë magazinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjembërimit Tiranë Rruga 5 “Maji” në praninë e grupit të marrjes në dorëzim.

Shenim: Për artikujt me numër rendor :1,2,3,4,5,6,7,8,14,15 pasqyruar ne tabelen e mëposhtme ditën e hapjes së ofertave duhet të dorëzohet nga një monstër pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit e Gjembërimit në praninë e komisionit të vlersimit të ofertave.

Nr.	Emërtimi	Njësia	Monstra te cilat do te sillen ne DPPGJ
1	Frezë me dy goma (Diesel)	Copë	1
2	Motokorëse me (Benzinë)	Copë	1
3	Motoseke me (Benzinë)	Copë	1
4	Motosharrë me (Benzinë)	Copë	1
5	Motosharrë me (Benzinë)	Copë	1
6	Motosharrë në lartesi me (Benzinë)	Copë	1
7	Prerëse Bari me (Benzinë)	Copë	1
8	Traktor korrës me (Benzinë)	Copë	1
14	Matrapik	Copë	1
15	Matrapik për Agregate	Copë	1

LËVRIMI I MALLIT

Afati i levrimit te mallit do te jete 10 dite nga data e lidhjes se kontrates.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1-Freze me dy goma (Diesel) (Copë 2)

Specifikime teknike

- Fuqia jo me pak se : 8 KW
- Motorri : Naftë
- Nr. I cilindrave / shpejtesia e vleresuar : 1 / 3600 rpm
- Zhvendosja cm³ : 401
- Kapaciteti i serbatorit jo me pak se : 5 L
- Nr. i marsheve : 4 AV + 3 RM (ne te dyja drejtimet)
- Kthyhes : komandimi me leve
- Me diferencial
- Bllokues diferenciali : Azhornuar me levë
- Gjatesia max jo me shume se : 1768 mm
- Gjeresia min-max : 555-668 mm
- Pesha jo me shume se 153 Kg

2- Motokorese me Benzinë (Copë 8)

Specifikime teknike

- Cilindrata jo me pak se 26 cm³
- Fuqia jo me pak se 0,6kW
- Pesha jo me shume se 4.5 kg

3- Motoseke me Benzinë (Copë 8)

Specifikime teknike

-Cilindrata jo me pak se 26.5 cm³

-Fuqia jo me pak se 0,70kW

-Pesha jo me shume se 5 kg

4- Motosharrë me Benzinë (Copë 8)

Specifikime teknike

-Cilindrata jo me pak se 30 cm³

-Fuqia jo me pak se 1,1kW

-Pesha jo me shume se 4,5 kg

5- Motosharrë me Benzinë (Copë 6)

Specifikime teknike

Cilindrata jo me pak se 72 cm³

-Fuqia jo me pak se 3,9kW

-Pesha jo me shume se 7 kg

6- Motosharrë në lartësi me Benzinë (Copë 6)

Specifikime Teknik

-Cilindrata jo me pak se 31 cm³

-Fuqia jo me pak se 1kW

-Pesha jo me shume se 7.5 kg

-Gjatesia maksimale jo me pak se 350 cm

7.Prerese Bari me Benzinë (Copë 8)

Specifikime teknike

Fuqia: jo me pak se 2.0 HP

Motorri: jo me pak se 53 cc 2-kohe

Me 2 kohë benzine, e paisur me dy koka prerese metalike dhe me fije,te jete e shpejtë dhe efikase për të përmbushur të gjitha nevojat në prerjen e barit apo shkurreve.Te jete e ndërtuar nga materialet e cilësisë së lartë për të garantuar jetëgjatësi dhe siguri. Te jete e pajisur me sistem kundër vibrimit për përdorim më të lehtë dhe më të gjatë. Boshti prej alumini ul peshën ndjeshëm dhe sëbashku me dorezën e bën përdorimin te lehtë dhe efikas.Te jete e pajisur me

sistem ndezës të shpejtë dhe të sigurt për të garantuar performancë të shkëlqyer në kushtet më të rënda atmosferike.

8.Traktor korres me Benzinë (Copë 2)

Specifikime teknike

Rrota aktive: Po

Lartësia e prerjes: nga 28 deri 75 mm

Pesha: jo me pak se 31.6 kg

Kapaciteti i koshit të grumbullimit:jo me pak se 70 L

Gjerësia e lamës:jo me pak se 51 cm

Fuqia:jo me pak se 150 cc

Korrese bari me benzine, me rrota vetëlëvizëse. Me një strukturë të fortë çeliku dhe e pajisur me një lame prerese te cilesise se larte për të siguruar efikasitet optimal të prerjes. Doreze kontrolli te jete e rehatshme e cila ofron kontroll maksimal te korreses te frenimit te motorrit ergonomik. Rrotat e pasme te mëdha te ofrojne lëvizje më të buta në terrene të veshtire

9.Moto Gershere Krasitje (Copë 8)

Specifikime teknike

Materiali: Inoks

me celik te temperuar me cilesi te larte . Te jete e veshur me shtrese mbrojtese . Me doreza per te mundesuar punen pa lodhje, si dhe nje shtrese e rehatshme ne dore dhe jo rreshqitese. Te jete e pershtatshme te perdoret per druret me dege te forta dhe te njoma.

10.Pompë Spërkatëse Motorrike (Copë 8)

Specifikime teknike

Pompë spërkatje shpine, motorr 2- kohësh, depozitë jo me pak se 25 Lt. Te jete e përshtatshme për spërkatjet që do kryhet në serat,rruget dhe blloqet e banimit. Duke u mbajtur në shpinë ta bej spërkatjen më të lehtë dhe të shpejtë.

11.Fryrëse Gjethesh (Copë 8)

Specifikime teknike

Fryres gjethesh me shpejtesi fryrje deri ne 220 Km/h te jete I pershtatshem per mbetje te renda te rruges si gjethe te lagura etj. Te jete lehtesisht I montueshem dhe I cmontueshem.

12.Karoca Dore (Copë 40)

Specifikime teknike

Karroca e dorës e galvanizuar te kete një kapacitet jo me pak se 80 Lt/ 160 kg dhe te jete e pajisur me një rrotë pneumatike e cila është e përshtatshme për sipërfaqe të forta apo të buta dhe doreza gome. Materiali: strukturë me tuba çeliku, lyerje me pjekje, pjesa mbajtëse e

ndërtuar prej çeliku të galvanizuar për rezistencë ndaj kushteve atmosferike dhe për më shumë qëndrueshmëri.

13.Thithëse Gjethesh (Copë 8)

Specifikime teknike

Fuqia: jo me pak se 3000 W

Te gjeneroj shpejtesi deri ne 240 km/h te eres me kapacitet deri ne 650 m³/h.Te jete lehtesisht e manovrueshme,dhe ideale per pastrimin e hapësirave te medha nga gjethet dhe papastertite.

14.Matrapik (Copë 3)

Specifikime teknike

Pesha: jo me pak se 6.2 kg

Shpimi max në beton: N/A

Shpimi max në dru: N/A

Shpimi max në metal: N/A

Kthim xhirosh (majtas-djathtas) : Jo

Numri i rrotullimeve në minutë: jo me pak se 2900 rpm

Fuqia goditëse:jo me pak se 8.3 J

Fuqia: jo me pak se 1150 W

Funksioni: Godites

15.Matrapik për Agregate (Copë 1)

Specifikime Teknike

Pesha:jo me pak se 2900 KG

Impakti i shpejtesise:400-600 bpm

Presioni i funksionimit:135-145

Valvula e lehtesimit te presionit:Min 190 bar

Valvula e lehtesimit te presionit:Max 220 bar

Diapazoni i rrjedhjes se vajit:210-310L/min

Presioni mbrapa:jo me pak se 5bar (73psi)

Fuqia hyrese:jo me pak se 75 kw (101hp)

Diametri i mjetit:jo me pak se 160mm

Linja e presionit (IN):SAE 6000 PSI 1

Linja e presionit (OUT):SAE 6000 PSI 1 ¼

Madhesia e linjes se presionit:jo me pak se 26mm

Temperatura optimale e vajit:40-60

Diapazoni i lejuar i temperatures se vajit:20-80

Diapazoni optimal i vajit ne funksion te temperatures:30-60

Diapazoni i lejuar i viskozivitetit te vajit:20-1000

Pesha mbartese:nga 35 ton deri ne 55 ton

Niveli i zhurmes:jo me pak se 85 db(A) 35-50M

Njësia e Hartimit të Dokumentave, në hartimin e dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi, është mbështetur punes nga grupi i ngritur per hartimin e nevojave, specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe kriterëve te vecanta teknike, te procedures ne reference.

Gjithashtu NJP eshte bazuar në nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e nevojave, specifikimeve teknike, fond limit dhe kriterëve te vecanta teknike nga grupi i punes i ngritur me urdher te titularit te AK, Nr. 250 Prot, date 06.02.2023

Data e hapjes së ofertave planifikuar date 06.03.2023 Ora: 11:00

- www.app.gov.al
- **Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip.**
- **Dokumentat pa pagesë.**

Njësia e prokurimit, bazuar në parashikimet ligjore dhe në objektin e prokurimit, vendosi kriteret e kualifikimit, të cilat gjejnë pasqyrim në Shtojcën 7 të DST –ve, kriteret, të cilat u konsideruan si të nevojshme për përmbushjen e kontratës, në përpjestim me përmasat dhe veçoritë e objektit që prokurohet dhe konkretisht, si më poshtë vijon:

KRITERET E PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT të pa ndryshueshme nga ato të miratuar nga APP në setin standart të dokumentave të tenderit.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KU ALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a.** Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b.** Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c.** Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1;
- d.** Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarim, sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimeve bazuar në natyrën dhe përmasat e kontratës, specifikimet teknike, sasia e kërkuar e mallit, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia gjykon vendosjen e kriterëve si vijon :

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiros e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ushtrimore (2019,2020,2021) nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së parashikuar te kontrates.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 1 dhe 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për të rritur pjesmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjykojnë me të arsyeshme të sjellin edhe vërtetimin.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve te fundit ushtrimore (2019,2020,2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse Dega e Tatim Taksave te konfirmuara nga ky autoritet shoqëruar me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për të rritur pjesmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjykojnë me të arsyeshme të sjellin edhe bilancet.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kriteri do të konsiderohet i përmbushur edhe në rastet kur operatorët ekonomik zgjedhin të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021)

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:*

*"c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:***

- i) *totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;*
- ii) *ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;*
- iii) *iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE duhet të paraqesë bilancet siç kërkohet në pikën 2.2.2.

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe

në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore të Vitit 2022 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), për të cilat duhet të paraqesë një vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do ti kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve të deklaruar si më lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates, në vlerën jo më e vogël se 19 % e vlerës së perlllogaritur të kontrates.

- Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvorjen e mëparshme kërkon vërtetime të leshuara nga një ent public ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- Në rastin e përvorjes së mëparshme të realizuara me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë

19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që përvajtuesit të ngjashme per procedurat e thjeshtuara të jenë në vlerën jo më të vogël se 19 % të vlerës së përlogaritur të kontratës.,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen.

2.3.2.Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **ISO 9001: 2015** të akredituar nga Institucione të Huaja ose vendase gjithashtu të paraqesë edhe certifikatën e akreditimit, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin qe prokurohet.

Argumentim: Kërkesa e cilësisë të përcaktuar është vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të

ndërrmarjes në standartet e tregut. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet **te paraqese katalogun origjinal te prodhuesit ose kopje te noterizuara të përkthyer në gjuhën shqipe** me te dhenat teknike ku te jene pasqyruar te gjitha specifikimet e mallrave objekt prokurimi te cilat jane pasqyruara te sakta ne tabelen e sasise se mallit në menyre që te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, sipas shtojces 5 ne DST Mallra.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 6, në bazë të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo kerkese është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem Teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara.

Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar , si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike

2.3.4 Operatori ekonomik **duhet të paraqesë deklaratë mbi garancinë për mallin** për jo më pak se 6 muaj nga dita e furnizimit, si dhe marrjen përsipër të zëvendësimit të baterive/gomave, filtrave dhe pjeseve të ndryshme të kembimit me defekt për shkak të prodhimit ose cilësisë së dobët gjatë zbatimit të kontratës, pas marrjes së njoftimit nga AK. Operatori ekonomik duhet të deklarojë gjithashtu se do ta shoqërojë mallin me Certifikatën e garancisë së mallit objekt prokurimi në momentin e dorëzimit të tij tek Autoriteti Kontraktor pas lidhjes së kontratës.

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u garantuar se për një periudhë të arsyeshme prej 6 muajsh nga dita e furnizimit, mallrat objekt prokurimi do të përmbushin specifikimet teknike dhe do të mbulohen të gjitha problematikat që mund të lindin, por jo për faj të Autoritetit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike

- Pas finalizimit të këtij procesi për përgatitjen e specifikimeve teknike, grupi i punës, i ngritur me urdher Nr. 250 Prot date 06.02.2023, bazuar në nenet 34 dhe 36 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenet 12, 13, nenin 45 pika 2. 76 të VKM Nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, filloj punën për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës objekt prokurimi, bazuar pikës b/ të nenin 76 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit:

Bazuar në nenin 76 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në përllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet të referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) çmimet e botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Grupi i Punës, duke marrë në konsideratë rastin në fjalë, natyrën/specifikat e këtij prokurimi, legjislacionin dhe rregullat e tregut për këtë blerje, ka organizuar punën dhe ka ndërmarrë hapa konkret për secilën nga alternativat e përcaktuara në nenin 76 të VKM 285/2021 për llogaritjen e vlerës limit të kontratës (fondit limit), me qëllimin që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. Lidhur me këtë proces, grupi i punës ka argumentuar dhe dokumentuar referuar materialeve bashkelidhur, konkretisht:

Ne rastin konkret AK i është referuar nenit 76 pikes 1 germa “b” te VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ” Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.

- ***Sa i përket respektimit të pikës “b”, Grupi i Punës, bazuar në rregullat e tregut, ka kryer studimin e tregut nëpërmjet marrjës së ofertave, për të njohur për aq sa është e mundur, nivelin e tregut aktual. Operatorët Ekonomik të përzgjedhur në mënyrë rastësore për marrjen e ofertave për testimin e tregut, janë subjekte tregtare të licensuara dhe të regjistruar pranë QKB dhe referuar objektit të veprimtarisë së tyre të publikuara në faqet on-line respektive, por edhe sipas Ekstraktit të Regjistrimit publikuar në faqen zyrtare on-line të QKB, rezultojnë se kanë në objektin e veprimtarisë së tyre, fushen objekt prokurimi.***

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentimi: Specifikimet Teknike të mësipërme janë në përputhje me nenet: Neni 4, pika 38/b të LPP, si dhe nenit 40, pika 2; 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Theksojmë se ‘Specifikimet Teknike’ i shërbejnë AK për të patur garanci se malli i ofruar do të jetë në parametrat dhe në cilësinë e duhur.

Shënim: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Te gjithë dokumentat duhet të jenë originalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skuklifim.